



QENDRA
KINEMATOGRAFIKE
E KOSOVËS

Rr. UÇK No. 273, 10 000 Prishtinë
info@qkk-rks.com Kosovë
www.qkk-rks.com+381 38 213 227

QENDRA KINEMATOGRAFIKE E KOSOVËS

RAPORTI VJETOR I AKTIVITETEVE 2018

HYRJE

AKTIVITETET E QENDRËS KINEMATOGRAFIKE TË KOSOVËS

Sukseset në festivale

PJESËMARRJA NË TREGJE TË FILMIT

Berlinale 2018

Cannes 2018

Annecy

Balkan Film Market

TIFFCOM në Tokio

PARTNERITETET DHE BASHKËPUNIMET NDËRKOMBËTARE

Les Arcs në Francë

Rotterdam Lab në Holandë

When East Meets West në Trieste, Itali

Ceremonia e European Film Awards në Berlin, Gjermani

Marreveshja me Turqinë

KONKURSI

Komisioni i Vizionimit të Përhershëm

KOMISIONI I VIZIONIMIT TË PËRHERSHËM

PROJEKTET NË ZHVILLIM

PLANI 2018

HYRJE

Qendra Kinematografike e Kosovës, si institucion me atributet e autoritetit qendror për kinematografi, ka për objektiv realizimin e politikave në fushën e kinematografisë që pasqyrojnë interesin publik.

Viti 2018 shënon një vit të suksesshëm për këtë institucion, që e karakterizojnë ngjarjet e shumta, si pjesëmarrja shumë më e gjerë e QKK-së në tregje të filmit, pjesëmarrja më e madhe e filmave në festivale të kategorisë ‘A’, nënshkrimi i marrëveshjeve në të mirë të filmbërësve dhe zhvillimi e realizimi i shumë projekteve filmike.

AKTIVITETET E QENDRËS KINEMATOGRAFIKE TË KOSOVËS

Sukseset në festivale

Sivjet Kosova ka pasur suksese të jashtëzakonshme në festivale ndërkombëtare, duke qenë e pranishme në shumë festivale të kategorisë ‘A’, gjë që tregon për një zhvillim të shpejtë të filmave kosovar.

Filmi “Martesa” nga Blerta Zeqiri njehereit fituese ne Tallinn Black Nights filloi shfaqjen në Cineplexx Kosovo dhe në Dokukino. Ne Cineplexx pati shikueshmëri te jashtëzakonshme duke thyer rekordin e shikueshmërisë. Poashtu filmi “Martesa” ka fituar nje mori çmimesh nderkombetare, si çmimi “Filmi me i mire” ne garen CineBalkan te Festivalit te filmit evropian Cinedays ne Shkup,

Poashtu filmi “Martesa” filloi te shfaqet ne platformat digjitale si iTunes, Google play, Amazon, You tube, Vudu, Fandango Now, Dish Network dhe permes sherbimeve locale kabllore si dhe ne kinema te zgjedhura ne SHBA.

Filmi “Ajo” me skenar dhe regji te More Raçes pati premieren dhe ishte ne konkurence zyrtare ne festivalin e kategorise A Cairo International Film Festival.

Filmi “Gardhi” nga Lendita Zeqiraj triumfon ne Palm Springs si filmi me i mire i shkurte dhe fitoi te drejten e garimit per OSCAR, fito, fitoi çminin kryesor ne Hamptons Film Festival ne SHBA.

Filmi “Nentor ii ftohte” pati premieren nderkombetare ne San Sebastian-Spanje dhe triumfoi ne Zurich Film Festival dhe Bosphorus Film Festival, si dhe u shfaq premiere ne Thessaloniki International Film Festival ne te cilin aktori kryesor i filmit Kushtrim Hoxha u shpall aktori me i mire.

Në edicionin e 59’të të Festivalit Ndërkombëtar të Filmit të Selanikut që do të mbahet nga data 1 deri më 11 Nëntor, Kosova përfaqësohet me 2 filma: “Nëntor i Ftohtë” i regjisorit Ismet Sijarina dhe “Gardhi” nga regjisorja Lendita Zeqiraj.

SEE Cinema Network

Këtë vit, QKK mori pjesë në takimin e Asamblesë së Përgjithshme të South Eastern Europe CINEMA NETWORK.

SEE Cinema Network e themeluar në vitin 2000, është rrjet i shteteve të Evropës Juglindore, që synon zhvillimin e bashkëpunimit mes profesionistëve të filmit dhe shteteve anëtare të saj, duke mbështetur zhvillimin e bashkëprodhimeve ndërkombëtare dhe prodhimin e filmave të shkurtër. Qëllimet kryesore janë promovimi dhe zhvillimi i industrisë filmike kombëtare të secilit vend pjesëmarrës, për të forcuar bashkëpunimin dypalësh dhe shumëpalësh me anëtarët e rrjetit.

Në takimin e asamblesë gjenerale të SEE Cinema Network që u mbajt këtë vit në Tiranë u vendos që të mbështeten 8 projekte nga vendet anëtare të rrjetit, e nga Kosova projekti fitues ishte ai i regjisores Sefa.



Premierat gjatë vitit 2018

- Filmi “Martesa” me producent: Kreshnik Berisha, morri pjese ne Festivalin nderkombetare Istanbul Film Festival.
- Filmi “Me dasht, me dasht, me dasht” dha premieren nderkombetare ne festivalin ne Toronto “HotDocs”.
- Filmi “Martesa” dha premieren nderkometare ne Tansilvania Film Festival, ne Rumani.
- Filmat “KTHIMI” dhe “YEAR OF MONKEY” dhane premieren ne Shkup.
- Filmi “Nentori i ftohte”, i regjisorit Ismet Sijarina dha premieren Ne Festival de San Sebastian-Spanje.
- Filmi i shkurtër ‘Një Muaj’ me skenar dhe regji nga Zgjim Terziqi dhe producent Agon Sylja, i cili pati premierën botërore në festivalin e madh Cairo International Film Festival.
- Filmi ‘Me dasht’, me dasht’, me dasht’ nga Ilir Hasanaj, film ky që pati premierën kombëtare në DokuFest.
- Në tregun e filmit EFM u shfaqen për audiencë të caktuar dy filma, filmi ‘Martesa’ nga Blerta Zeqiri dhe filmi ‘Kthimi’ nga Kastriot Abdyli.
- Filmi “Me dasht me dasht me dasht” në festivalin American Documentary Film Festival në Palm Springs.
- Filmi “Ajo” i More Races ishte nje nga nente filmat finalist ne festivalin Manhattan Short Film Festival, u shfaq per nje jave ne kinema ne Los Angeles, po ashtu fitoi te drejten per aplikim per Oscar.

- Filmi i metrazhit te gjate “Kthimi” nga Kasteriot Avdyli, i subvencionuar nga QKK, ka marre pjese dhe ka qene ne konkurence zyrtare ne Oldenburg International film Festival, ne Gjermani.
- Filmi „Delegacion“ me skenar të Artan Minarolli e me regji të Bujar Alimani ne muajin tetor u shfaq premierë në konkurrencë ndërkombëtare në festivalin e kategorise A Warsaw Film Festival.
- Qendra Kinematografike e Kosovës në bashkëpunim me Këshillin Nacional Shqiptarë organizuan Javën e Filmit të Kosovës në Bujanoc ne dhjetor. Java e filmit u hap me filmin e regjisorit Ismet Sijarina; “Nëntor i Ftohtë” dhe vazhdoi me “Home Sweet Home” nga Faton Bajraktari, “Tri Dritare dhe Një Varje” nga Isa Qosja, “T’padashtun” nga Edon Rizvanolli dhe “Një Tregim Prishtine” nga Burbuqe Berisha.

PJESËMARRJA NË TREGJE TË FILMIT

QKK këtë vit ka pasur përfshirje shumë të madhe në tregjet e filmave ndërkombëtar ku përveç atyre që është prezente zakonisht, si në Berlinale dhe Cannes, këtë vit ishte pjesë edhe ne Les Arcs-France, Cineuropa, See Cinema Network, Rotterdam, Hot Docs-Canda, Balkan Film Market në Shqipëri dhe TIFFCOM në Tokio.

Berlinale 2018

Në muajin shkurt Qendra Kinematografike e Kosovës vazhdoi prezencën e saj në tregun e madh të filmit, European Film Market, në festivalin prestigjioz Berlinale.

QKK edhe sivjet ndau shtandin me Qendrën Kombëtare të Kinematografisë së Shqipërisë, ku gjatë asaj kohe, profesionistë ndërkombëtar të filmit patën mundësinë të informohen me të rejat e industrisë së filmit kosovar dhe anasjelltas.

Disa prej filmave të përfshirë në katalog janë: 'Cirku Fluturues' nga Fatos Berisha, 'Hana' nga Ujkan Hysaj, 'Kodra e Diellit' nga Blerim Gjoci, 'Fusha e Mëllenjave' nga Arzana Kraja, 'Aga' nga Lendita Zeqiraj, 'Familje' nga Durim Kryeziu, 'Qiej të Trazuar' nga Anton Ndreca, 'Martesa' nga Blerta Zeqiri, 'Ajo' nga More Raça, 'Klithmë' nga Korab Lecaj, 'Drita' nga Rita Krasniqi, 'Urtësia' nga Bujar Berisha, 'Aktorët e Kanës' nga Mentor Spahiu etj.

Gjithashtu në tregun e filmit EFM u shfaqen për audiencë të caktuar dy filmat, bashkëprodhime kosovare, të mbështetura nga QKK, filmi ‘Martesa’ nga Blerta Zeqiri dhe filmi ‘Kthimi’ nga Kastriot Abdyli.

Në Berlinale ishin prezent edhe tre aktorët kosovarë, Andi Bajgora, Florist Bajgora, Arbresha Grabovci Nixha me filmin holandez ‘Kiem Holijanda’ nga Sarah Veltmeyer, film ky që pati premierën në këtë festival në programin Generation 14plus.



Cannes 2018

Qendra Kinematografike e Kosovës bashkë me atë të Shqipërisë do të jenë pjesë e tregut të madh 'Marche Du Film' të festivalit prestigjioz të Kanës nga data 8 deri më 17 maj 2018.

Këtë vit lokacioni i pavijonit do të jetë në një hapësirë më të mirë dhe pranë shteteve me industri më të zhvilluar të filmit. Pavijoni do të jetë i vendosur afër shteteve të Evropës Juglindore, Republikës Çeke, Sllovakisë, Amerikës, Gjermanisë etj.

Në 'Marche Du Film' do të prezentohen të rejtat e kinematografisë kosovare, si me anë të katalogut, ashtu edhe duke i prezentuar të gjithë filmat e mbështetur nga QKK para producentëve ndërkombëtar, përfaqësuesve të fondeve të filmit, të festivaleve, agjentëve të shitjes, distributorëve etj.

Gjatë qëndrimit në Kanë do të mbahen shumë takime me partnerë ndërkombëtar të kinematografisë, fonde filmi, përfaqësues të festivaleve të mëdha ndërkombëtare, producentë e distributorë të ndryshëm ku edhe pritet të nënshkruhen disa marrëveshje.



Duke pasur parasysh faktin se bashkëpunimi i ndërsjellë mund të shërbejë në zhvillimin e prodhimit të filmit dhe të inkurajojë zhvillimin e mëtejshëm të lidhjeve kulturore dhe teknologjike midis dy vendeve; Duke pasur parasysh se bashkëprodhimi mund të jetë i dobishëm për industrinë filmike të vendeve tona dhe të kontribuojë në rritjen e industrisë së filmit, televizionit, videove dhe industrive të reja të prodhimit dhe distribuimit në Kosovë dhe Maqedoni; Duke kujtuar "Marrëveshjen ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për Bashkëpunimin në fushën e Kulturës, nënshkruar në Prishtinë më 8 shkurt 2013", sot në Festivalin

e Cannes Qendra Kinematografike e Kosovës dhe Agjencia e Filmit e Maqedonisë kanë nënshkruar marrëveshjen e bashkëprodhimit.



I pranishëm në ceremoninë e nënshkrimit ishte edhe Ministri i Kulturës z.Kujtim Gashi i cili u shpreh:”Është kënaqësi e veçant të jemë present në këtë moment historik të lidhjes së kësaj marrveshje e cila do të shërbej edhe më shumë për bashkëprodhimet në fushën e filmit, por edhe të njohjes së kulturës në mes të dy vendeve. Ministria e Kulturës çdo here do të jetë afër iniciativave të tilla që i fuqizojnë marrdhënjet ndërfqinjësore”.



Drejtori i Agjencisë së Filmit të Maqedonisë tha se: “Maqedonia dhe Kosova kanë bashkëpunim shumë të thellë në fushën e filmit, dhe sot si rezultat kemi këtë marrveshje shumë me rëndësi për të ardhem e filmëbërësve tanë”.

Balkan Film Market

QKK e Shqipërisë organizoi Balkan Film Market, tregun balkanik për lidhje të bashkëpunimit mes shteteve të rajonit. QKK ishte e pranishme në këtë treg me një delegacion prej filmbërësve kosovare, që ishin pjesë e lidhjeve të kontakteve me filmbërësit ballkanik. QKK planifikon që të merr pjesë në BFM edhe vitin që vjen.

Projektet të cilat u mbështetën këtë vit janë: “Skype” nga regjisori Isa Qosja, “Hive” nga Blerta Basholli, “Vera enderron detin” nga Kaltrina Krasniqi dhe “Rapsodia e muzgut” nga Agim Sopi.



TIFFCOM

Kosova për herë të dytë ishte pjesë e tregut TIFFCOM, aleatët e festivalit të madh Tokyo International Film Festival, ku në bashkëpunim me Ambasadën e Kosovës në Japoni pati rastin të prezantoi industrinë e filmit kosovar në Japoni.

Japan Content Showcase 2018 (Tiffcom) është treg i madh i industrisë së filmit, TV, film dhe animacion.

TIFFCOM - Tregu i lidhur me Festivalin Ndërkombëtar të Filmit të Tokios (TIFF - Festivali i vetëm i filmit në Japoni i miratuar nga Federata Ndërkombëtare e Shoqatave të Producentëve të Filmit) TIAF - Tokyo International Anime Festival.



PARTNERITETET DHE BASHKËPUNIMET NDËRKOMBËTARE

Qendra Kinematografike e Kosovës viteve të fundit është përkujdesur me intenzitet të lartë në avancimin e producentëve kosovar duke nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me tregun e bashkëprodhimit të festivalit evropian të njohur Les Arcs European Film Festival në Francë, me Rotterdam Lab, pjesë e International Film Festival Rotterdam në Holandë si dhe me When East Meets West, e cila do të mbahet në fillim të 2018-tës në Trieste, CineEorpa

Këto bashkëpunime do të vazhdojnë gjatë vitit 2018, pasi që ndihmojnë zhvillimin e producentëve në arenat ndërkombëtare duke e parë shumë të nevojshme avancimin e tyre dhe filmbërjen në Kosovë.

Gjithashtu, QKK i ka kushtuar rëndësi të veçantë zhvillimit sa më të madh të bashkëpunimeve ndërkombëtare. Me këtë rast janë hartuar drafte të bashkëprodhimit ndërkombëtarë me Maqedoninë si dhe janë finalizuar me nota verbale marrëveshjet me Turqinë dhe Bullgarinë.

Les Arcs European Film Festival në Francë

Në vitin 2018, 4 filmbërës përfituan nga marrëveshja e QKK-së dhe Les Arcs, ndërsa 2 nga ta kanë marrë pjesë, duke qenë pjesë e tregut të madh të bashkëprodhimit në Francë, ku të pranishëm ishin: Valon Bajgora dhe Ilinka Iljoska dhe drejtori i QKK-së-Arben Zharku.

QKK është shumë e interesuar të ruaj këtë marrëveshje edhe në vitet në vazhdim pasi që është mundësi e jashtëzakonshme për lidhje të kontakteve si dhe për avancim të producentëve.

Rotterdam Lab

Rotterdam Lab është punëtorja për producentët në zhvillim, me të cilët QKK ka lidhur marrëveshje, duke mbështetur producentët e ri të jenë pjesë e kësaj punëtorie dhe të kenë rastin të prezantojnë projektet e tyre filmike. Pjesë e kësaj punëtorie pesë ditore ishin Blerim Gjoci me projektin filmik 'Kodra e Diellit' si dhe Ujkan Hysaj me projektin 'Hana', të dy këta filma, të mbështetur nga Qendra Kinematografike e Kosovës.

When East Meets West në Trieste, Itali

QKK ka arritur këtë vit marrëveshje edhe me When East Meets West, i cili është forum i bashkëprodhimit me fokus vjetor në Evropën Lindore dhe Perëndimore.

Ky forum ndihmon producentët të identifikojnë fonde të ndryshme dhe fonde alternative, si dhe ndihmon në mundësitë e distribuimit në rajonet që kanë më shumë vëmendje, gjithashtu, lehtëson në procesin e bërjes së politikave midis territoreve në fokus, në mënyrë që të nxiten bashkëprodhime të reja ndërmjet industrive që ende nuk janë të lidhura mirë.

Pjesë e delegacionit të udhëhequr nga drejtori i QKK-së, ishin filmbërësit me projektet e tyre filmike, si: Bujar Kabashi me projektin 'Aga', Ujkan Hysaj me 'Hana', Blerim Gjoci me 'Kodra e Diellit', Besnik Krapci me 'Fusha e Mëllenjave' dhe Fatmir Spahiu me projektin 'Njeri i Dosjeve'.

QKK edhe në vitin 2017 ka vazhduar bashkëpunimin me Cineuropa, për promovimin e filmave kosovarë në botë përmes Newsletters, të cilat Cineuropa i shpërndanë dhe përmes artikujve për filmat kosovar.

Cineuropa është magazina më e madhe e industrisë së filmit, e cili i dha QKK-së dukshmëri të madhe ndërkombëtare, pasi që ka databazë tejet të pasur të industrisë së filmit në botë. QKK përmes newsletter që dërgon çdo muaj, ishte e pranishme në të gjitha mediumet ndërkombëtare.

Anëtarësimi i Kosovës në Creative Europe Fuqizon Sektorin Kreativ dhe Kulturor

Ne fillim të qershorit, Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të Kosovës, Z. Kujtim Gashi dhe Z. Tibor Navracsics, Komisioneri Evropian për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport nënshkruajtën marrëveshje për pjesëmarrjen e Kosovës në Creative Europe.



Me rastin e Ceremonisë së Nënshkrimit në Bruksel, Komisioneri Navracsics theksoi se pjesëmarrja e Kosovës në Creative Europea do të forcon bashkëpunimin kulturor midis Bashkimit Evropian (BE) dhe Kosovës. Për më tepër, Kosova bashkohet në një kohë kur BE'ja feston Vitin Evropian të Trashëgimisë Kulturore, një mundësi e madhe për të rritur ndërgjegjësimin për trashëgiminë e përbashkët kulturore dhe kontributin e saj pozitiv në ekonominë, zhvillimin shoqëror, dhe identitetin evropian. Kosova po i bashkohet nënprogramit të Kulturës dhe degës ndërsektorial të Creative Europe.

Me hyrjen e Kosovës në Creative Europe të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor (gjashtë shtete), tani marrin pjesë në program. Pjesëmarrja në Evropën Krijuese do të ofrojë mundësi të reja për të mbështetur sektorët kulturorë dhe krijues në Kosovë. Ajo gjithashtu do të ndihmojë bashkë-krijimin, mirëkuptimin e ndërsjellë, krijimin e hapësirave për kontaktet njerëzore, dhe ndërtimin e urave mes krijuesve.

KONKURSI 2018



Në muajin qershor janë bërë të gjitha përgaditjet e fundit për prezentimin të projekteve aplikuese përpara jurisë vlerësuese. Gjithashtu në fund të muajit qershor, saktësisht me 28 qershor, është mbajtur prezentimi i projekteve të metrazhit të shkurtër dhe më pas janë shpallur vendimet e jurisë.

Juria vlerësuese e përbërë nga: Isa Qosja, Giovanni Battista Robbiano, Doruntina Basha, Ilir Gjocaj, Blerta Zeqiri, Jozko Rutar dhe Florent Mehmeti kanë vendosur të mbështesin këto projekte:

Në kategorinë e filmit të metrazhit të shkurtër artistik janë mbështetur:

Titulli i Projektit: Qaty a qitu; Shtëpia Filmike: Supercut Production; Producentja: Adea kelmendi; Skenaristja: Dina Morina; Regjisorja: Dina Morina

Titulli i Projektit: "Ombrella"; Shtëpia Filmike: OM; Producenti: Xhemajl Avdyli Skenaristi: Ag Apolloni; Regjisor: Ben Apolloni

Titulli i Projektit: Rruga "Fan Noli"; Shtëpia Filmike: Djemt e Abdullahit; Producenti: Milot Hoxha; Skenaristi: Milot Hoxha; Regjisorja: Jehona Berisha

Në kategorinë e filmit dokumentar janë mbështetur:

Titulli i Projektit: "Thyeje Heshtjen"; Shtëpia Filmike: In My Country post production; Producenti: Kushtrim Sheremeti; Skenaristi: Ekrem Rrahmani; Regjisor: Ekrem Rrahmani.

Titulli i Projektit: "Skenderbeu edhe në Shkup"; Shtëpia Filmike: N.SH. Shkupi Film; Producentja: Venera Abdyli; Skenarist: Kastriot Abdyli; Regjisor: Kastriot Abdyli.

Titulli i Projektit: "Lufta per shkollen", Shtëpia Filmike: N.I., Producenti: Nuhi Bytyci, Skenaristi: Nuhi Bytyci, Regjisor: Ilir Kabashi

Titulli i Projektit: "Fisi i humbur", Shtëpia Filmike: SORRA" SH.P.K, Producenti: Fitim Shala, Skenaristi: Garentina Kraja, Regjisor: Arzana Kraja

Titulli i Projektit: "Rrugetimi im nga Shkupi, permbi Zagreb, deri...", Shtëpia Filmike: N.M. "Blue Point", Producenti: Kujtim Shabani, Skenaristi: Mirjana Novak Perjanec, Regjisor: Mirjana Novak Perjanec

Titulli i Projektit: “Kosova dhe Hebrenjtë”, Shtëpia Filmike: AS- FILM, Producenti: Lorena Sopi, Skenaristi: Jakov Sedlar, Rabbi Robert Selzer, Regjisori: Jakov Sedlar.

Në kategorinë zhvillim skenari janë mbështetur:

Titulli i Projektit: “Hotline”; Shtëpia Filmike: N.SH. N'Art; Producenti: Bujar Kabashi; Skenaristi: Dren Zherka; Regjisori: Dren Zherka.

Titulli i Projektit: “Hunting Bears”; Shtëpia Filmike: N.SH. C M B; Producenti: Mentor Shala; Skenaristi: Edon Rizvanolli.

Titulli i Projektit: “The Tiny Walkers”; Shtëpia Filmike: In My Country Production Sh.p.k.; Producenti: Jeton Kulinxha; Skenaristi: Jeton Kulinxha.

Titulli i Projektit: "Njeriu me valixhen vjollcë"; Shtëpia Filmike: Kandërr; Producenti: Edin Alija; Skenaristja: Ulpiana Maloku

Titulli i Projektit: “Tifozi i Jugosllavise”, Shtëpia Filmike: N.SH. Industriel, Producenti: Arian Krasniqi, Skenaristi: Arian Krasniqi.

Titulli i Projektit: “Ikja”, Shtëpia Filmike: Fokus Film, Producenti: Artur Tahiraj Skenaristi: Artur Tahiraj.



1.

Në fund të muajit qershor është mbajtur prezentimi i dytë përpara jurisë të projekteve që kanë aplikuar në konkursin e projekteve të metrazheve të gjata. Me datën 30 qershor është mbajtur prezentimi ndërsa me vone janë shpallur fituesit.

Juria vlerësuese për projektet e metrazhit të gjatë artistik, debutant dhe koproduksion minor, e përbërë nga: Ilir Bokshi, Ilir Ajdini, Jahi Jahiu, Mentor Aliti, Visar Krusha, Visare Niksic, Arbenesha Grabovci Nixha-anëtarë, pasi shqyrtuan projektet e paraqitura në konkurs, vendosën t’i mbështesin këto projekte:

Në kategorinë e filmit të metrazhit të gjatë – artistik janë mbështetur 6 projekte:

Titulli i Projektit: “Exil”; Shtëpia Filmike: N.P.SH. Ikone- Studio; Producenti: Yll Uka; Skenaristi: Visar Morina; Regjisori: Visar Morina.

Titulli i Projektit: “Në kërkim të Venerës”; Shtëpia Filmike: Circle Production SH.P.K.;

Producenti: Besnik Krapi; Skenaristi: Norika Sefa; Regjisori: Norika Sefa.

Titulli i Projektit: “Rapsodia e Muzgut”; Shtëpia Filmike: A-S Film; Producenti: Besim

Ugzmajli; Skenaristi: Zymber Kelmendi; Regjisori: Agim Sopi.

Titulli i Projektit “Debora”, Shtëpia Filmike “Raven City Production”, Producenti: Luigj Bejta,

Skenaristi: Arlinda Morina, Regjisori: Arlinda Morina.

Titulli i Projektit “Lëkura e krokodilit”, Shtëpia Filmike: N.SH. Filmtory 2656, Producenti:

Teuta Krasniqi, Skenaristi: Ilirjan Himaj, Regjisori: Ilirjan Himaj.

Titulli i Projektit “Heshtja e Sirenave”, Shtëpia Filmike: N.SH. FRAME, Producenti: Arben

Shala, Skenaristi: Gazmend Nela, Regjisori: Gazmend Nela.

Në kategorinë e filmit të metrazhit të gjatë artistik – debutant është mbështetur projekti filmik:

‘Titulli i Projektit: “Galaktika e Andromedës”; Shtëpia Filmike: N.SH. Arena; Producenti:

Synaj Raça; Skenaristja: More Raça; Regjisoria: More Raça.

Në kategorinë e metrazhit të gjatë artistik – Koproduksion Minor, juria vendosi të mbështes 3 projekte:

Titulli i Projektit: “Liqeni im”; Shtëpia Filmike: Added Value Films SH.P.K.; Producenti:

Liridon Cahani; Skenaristi: Gjergj Xhuvani; Regjisori: Gjergj Xhuvani.

Titulli i Projektit: “Illyricvm”; Shtëpia Filmike: Buka sh.p.k.; Producenti: Fatmir Spahiu;

Skenaristi: Simon Bogojevi Narath; Regjisori: Simon Bogojevi Narath.

Titulli i Projektit: “Homo”; Shtëpia Filmike: Trigger L.L.C. Producenti: Lumbardh Kukaj;

Skenaristi: Igor Ivanov; Regjisori: Igor Ivanov.

Festivalet vendore

Festivali Ndërkombëtar i Filmit i Prishtinës filloi me date 17.07.2018 dhe hapi edicionin e saj të 10 me ROOFTOP STORY, një film nga regjisori Gazmend Nela i cili u shfaq premiere në Kosovë pas asaj të Montrealit. Si dhe shtatë filma të tjerë të përkrahur nga Qendra Kinematografike u shfaqen në këtë edicion si: MARTESA nga Blerta Zeqiri, GJUMË DHE DASHURI nga Arsim Haliti, NJË TREGIM PRISHTINË nga Burbuqe Berisha, ME DASHT, ME DASHT, ME DASHT nga Ilir Hasanaj, KLITHMA nga Korab Lecaj, VITI I MAJMUNIT nga Vladimir Blazevski, dhe mbyllja e festivalit u bë me date 22.07.2018 me filmin KTHIMI nga Kastriot Abdyli.

Java e filmit ne Bujanoc

Qendra Kinematografike e Kosovës në bashkëpunim me Këshillin Nacional Shqipëtar organizoi Javën e Filmit të Kosovës në Bujanoc nga data 10 deri më 15 dhjetor.

Gjatë javës së filmit në Bujanoc u shfaqen pesë filma të metrazhit të gjatë që janë realizuar në vitet e fundit në Kosovë.

Java e filmit u hap me filmin e regjisorit Ismet Sijarina; “Nëntor i Ftohtë”, dhe do të vazhdoi me “Home Sweet Home” nga Faton Bajraktari, “Tri Dritare dhe Një Varje” nga Isa Qosja, “T’padashtun” nga Edon Rizvanolli dhe “Një Tregim Prishtine” nga Burbuqe Berisha.

Filmat u shfaqen në Shtëpinë e Kulturës çdo ditë nën përkujdesjen e koordinatorit për kulturë pranë kabinetit të Kryetarit të Komunës së Bujanocit z.Nagip Taipi.

Festivali Frankofon i Filmit

Edicioni i 18-të i Festivalit të Filmit Frankofon, zgjati dhjetë ditë dhe u shfaqen pesëmbëdhjetë filma, katër prej të cilëve janë filma Kosovarë të mbështetur nga Qendra Kinematografike e Kosovës. Filmat të cilët u shfaqen në KINO ABC janë “Martesa” me regji nga Blerta Zeqiri, “Home Sweet Home” me regji nga Faton Bajraktari, Gardhi” me regji nga Lendita Zeqiraj, dhe “T’padashtun” me regji nga Edon Rizvanolli.

OSCARS 2018

Edhe këtë vit, QKK dërgoi propozimin kosovar për Akademinë më të madhe të filmit Oscars, ku edhe sivjet si çdo vit që nga kualifikimi i shtetit të Kosovës për propozim, u vendos nga komiteti selektues të shtyjnë përpara filmin e gjate artistic “Martesa” nga Blerta Zeqiri.

Filmi “Martesa”, që u përkrah financiarisht nga Qendra Kinematografike e Kosovës (QKK), flet për një trekëndësh dashurie pranë dhe gjatë një martese. Treshen e personazheve kryesore të filmit me skenar të Blerta Zeqirit dhe Keka Kreshnik Berishës e interpretojnë Alban Ukaj, Adriana Matoshi dhe Genc Salihu. Përveç QKK-së, “Martesa” u përkrah edhe nga Qendra Kombëtare Kinematografike e Shqipërisë.



KOMISIONI I VIZIONIMIT TË PËRHERSHËM

Qendra Kinematografike e Kosovës, përkatësisht Këshilli Drejtues i QKK-së, këtë vit ka formuar Komisionin e Vizionimit, i cili do të angazhohet në dhënien e lejes për shfaqje publike të gjithë filmave që prodhohen në Kosovë.

Në bazë të Ligjit për Kinematografi, neni 9, par. 9.1. dhe 9.2 Komisioni i Vizionimit ka të drejtë të jep leje për shfaqjen publike të filmit sipas kategorive, të cituar:

”9.1. Për çdo film vendës apo të huaj që synohet të shfaqet publikisht, para se të ketë shfaqjen e parë në Kosovë, distributori, perkatësisht shfaqësi duhet të merr lejen për shfaqjen publike të filmit.

9.2. Lejen nga paragrafi i mësipërm, e jep Komisioni i Vizionimit i QKK.”

Komisioni i Vizionimit pritet të luaj rol shumë të rëndësishëm në krijimin e një ambienti më të përshtatshëm për publikun e të gjitha moshave si dhe parandalimin e shfaqjes së filmave që nxisin urrejtje etnike, raciale, religjioze etj.

Anëtarët e Komisionit të Vizionimit të emëruar nga QKK janë: Veton Nurkollari, drejtor artistik i festivalit DokuFest, Linda Gusia, sociologe, Imer Mushkolaj, publicist & aktor, Birol Urcan, regjisor, dhe një person ad-hoc, i cili caktohet nga QKK, i ndryshëm për secilin film.



PROJEKTET NË ZHVILLIM

Përveq 8 premierave të filmave të mbështetur nga QKK, shumë projekte tjera janë në faza të ndryshme të zhvillimit. Gjatë këtij viti kanë filluar xhirimet rreth 25 filma të metrazhe ve të ndryshme, prej të cilëve 17 projekte filmike i kane perfunduar xhirimet, disa janë ende duke xhiruar e të tjerët janë në post-production, ndërsa 12 filma kane marre lejen për shfaqje.

PLANI PËR 2019

Për vitin 2018, QKK planifikon futjen në funksion të Rregullores për lehtësirat financiare, të cilat do të tërheqin investime të huaja në Kosovë, në fushën e industrisë së filmit, rregullore kjo që inkurajon dhe u hap rrugën investitorëve të huaj për të xhiruar në Kosovë.

Poashtu vitin e ardhshëm QKK planifikon të hartojë Rregulloren për parandalimin e konfliktit të interesit, e cila rregullore do të precizojë konfliktin e interesit në të gjitha rastet me të cilat janë ndeshur zyrtarët e QKK-se.

Gjatë vitit 2019 shpresojmë që të hyj në funksion edhe Rregullorja e Ministrisë së Kulturës për sponsorizime, që do të jetë edhe një mundësi më shumë në gjetjen e fondeve alternative për filmbërësit kosovar.